



KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 2.7.2019

Dokument parlamentar

RAPORT PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 2018 PËR PROJEKTIN “PROGRAMI SEKTORIAL I UJËRAVE/ FURNIZIMI ME UJË I ZONAVE RURALE IV”

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, bazuar në nenet 32 - 38 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2018, për projektin “Programi sektorial i ujërave/ Furnizimi me ujë i zonave rurale IV”, në mbledhjen e tij të datës 2 korrik 2019.

Komisioni caktoi relator për këtë projektligj Zotin Arben PËLLUMBI.

Të pranishëm gjatë shqyrtimit të projektligjit ishin përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe të OSHEE sh.a.-së.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2018, për projektin “Programi sektorial i ujërave/ Furnizimi me ujë i zonave rurale IV” është nismë e Këshillit të Ministrave dhe i paraqitet për shqyrtim Kuvendit mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 121 pika 1 të Kushtetutës.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 1 e Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit***

Projektligji synon ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2018, për projektin “Programi sektorial i ujërave/ Furnizimi me ujë i zonave rurale IV”. Ky investim është pjesë e një pakete mbështetëse të financuar nga Qeveria Gjermane përmes KfW-së. Vlera e këtij bashkëpunimi është 40 milionë euro dhe 2 dy milionë euro grant.

Programi sektorial i ujërave/furnizimi me ujë i zonave rurale IV, i përgjigjet prioriteteve dhe qëllimeve të vëna për zhvillimin ekonomik të vendit. Gjithashtu, ky program mbështetet në Strategjinë Kombëtare për Furnizimin me Ujë dhe Kanalizimet dhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 – 2020.

Qëllimi i projektit “Furnizimi me ujë i zonave rurale IV” është përmirësimi i infrastrukturës së ujësjellësve dhe kanalizimeve, nëpërmjet sigurimit të qëndrueshëm në furnizimin me ujë të pijshëm për popullsinë rezidente dhe turistët në zonën e projektit, me kosto sociale të pranueshme dhe tarifa që i mbulojnë kostot, si dhe të saniteteve të përshtatshme, nëpërmjet sistemit të kanalizimeve, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura dhe përmirësimit të kapaciteteve menaxhuese.

Programi “Ujësjellësat Ruralë IV” do të zbatohet në një zonë që përfshin Bashkinë Himarë, ku futen qyteti i Himarës dhe fshatrat Kuç, Buronjë (afër Kuç), Pilur, Kudhës, Vuno, Jalë, Livadhi, Himara Fshat, Qeparo e Borsh, vënia në punë e impinatit të trajtimit të ujërave të ndotura të Orikumit, instalimi i lidhjeve familjare për ujësjellësin në qytetin e Orikumit. Bashkia e Himarës konsiderohet si një nga rajonet më të rëndësishme turistike në Shqipëri, me një potencial të madh për zhvillim të mëtejshëm.

Fondet që do të sigurohen nga kjo marrëveshje do të përdoren për realizimin e investimeve në zonën bregdetare të jugut të Shqipërisë, duke u fokusuar në Bashkinë e Himarës dhe në Bashkinë Orikum.

Projekti që do të financohet nëpërmjet kredisë dhe grantit, si më sipër, është parashikuar në Programin Buxhetor Afatmesëm 2019-2021 të Fondit Shqiptar të Zhvillimit - Agjencisë së Zbatimit të Projektit, dhe, më konkretisht, në programin “Furnizimi me ujë i zonave rurale IV”.

- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare.***

Projektligji është në përputhje me nenet 78, 83, pika 1, dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, si dhe me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Në aspektin procedural projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në aspektin formal projektligji përbëhet nga 2 nene.

- ***Diskutimi në komision***

Relatori i projektligjit u shpreh që realizimi i këtij programi do të ndikojë në furnizimin e qëndrushëm me ujë të pijshëm për banorët dhe turistët në zonën e projektit, me kosto sociale të pranueshme dhe tarifa që i mbulojnë kostot.

Përfaqësuesit e Ministrisë shpjeguan elementët kryesorë të kësaj marrëveshjeje duke shtuar që parashikohet që ky projekt të kontribuojë në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe të promovojë zhvillimin e turizmit në zonën e projektit, duke e çuar numrin e përtituesve në 80 000 përfitues, përfshirë turistët.

Diskutimet në Komision, u përqëndruan kryesisht në gjendjen, ecurinë dhe treguesit aktualë të rrjetit të ujësjellësve; termat financiarë që do të kenë marrëveshjet financiare; si dhe projektet konkrete që mund të realizohen me këtë marrëveshje.

- ***Përfundim***

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni vlerësoi projektligjin për krijimin e mundësive për përmirësimin e rrjetit të ujësjellësve në zonën turistike ku do përfitojnë si banorët ashtu edhe tursitët.

Komisioni e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi me të gjitha votat e anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

Arben PËLLUMBI

Niko PELESHI

Relator

Kryetar